

LIGJ
Nr. 127/2024

**PËR SHFUQIZIMIN E MASAVE ADMINISTRATIVE TË VENDOSURA NGA DATA
1 JANAR 2015 DERI MË 30 NËNTOR 2024 NGA INSPEKTORATET VENDORE
TË MBROJTJES SË TERRITORIT, INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES
SË TERRITORIT, AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT, INSPEKTORATI
SHTETËROR SHËNDETËSOR, SI DHE POLICIA E SHTETIT E POLICIA
BASHKIAKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Neni 1
Masat administrative që shfuqizohen

Shfuqizohen të gjitha masat administrative të paekzekutuara deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, të vendosur nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024 nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake.

Neni 2
Përfituesit

1. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë bërë ndërtime dhe/ose ndërhyrje pa leje apo njoftim paraprak, në ndërtime për qëllime banimi, në objekte ku kryhen veprimtari të prodhimit, magazinimit, përpunimit, ruajtjes dhe tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe mbajtjes të mjeteve të punës e inputeve bujqësore dhe blegtorale.

2. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë objekt të aktivitetit të tyre prodhimin, përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në zonat rurale.

3. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët nuk kanë zbatuar rregullat e vendosura për administrimin e situatës COVID-19 gjatë periudhës së pandemisë.

Neni 3
Institucionet zbatuese

1. Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Këshilli i Ministrave, organet e qeverisjes vendore, të gjitha agjencitë dhe inspektoratet në varësi të tyre.

2. Këshilli i Ministrave brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji miraton me vendim procedurat që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të paekzekutuara sipas këtij ligji.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 19.12.2024.

Shpallur me dekretin nr. 441, datë 30.12.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.